



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2016
Nr. Dok. 201502119/6

Lënda : *Rekomandim për dhënien e ndihmës shtetërore për mbulimin e dëmit të shkaktuar nga përmbytjet e ndodhura në muajin Shkurt 2015, për shtëpinë e shtëtasit Q.A, me banim në fshatin Ferras, Levan, Bashkia Fier.*

Drejtuar : **Z. Shemsi Prençi**
Drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile
Ministria e Punëve të Brëndshme

TIRANË

Z. Armando Subashi
Kryetar i Bashkisë

FIER

Për dijëni: **Z. Xhevit Bushi**
Prefekt i Qarkut

FIER

Të nderuar zotërinj,

Sikurse ju kemi bërë me dije, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi Q.A, me banim në fshatin Ferras, Njësia Administrative Levan, Bashkia Fier. Në ankesë ngrihet shqetësimi se, në muajin Shkurt 2015 kur shtëpia e tij është dëmtuar krejtësisht, për shkak të përmbytjeve që ndodhën gjatë kësaj periudhe në këtë zonë, familja e tij nuk ka marrë dëmshpërblimin mbi bazën e vlerësimit financiar të dëmeve të përcaktuar nga komisionet e ngritura për këtë qëllim në nivel vendor, sipas procedurave të parashikuara në ligj dhe akte nënligjore.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke marrë në konsideratë problematikën e kësaj ankese dhe kushtet në të cilën ndodhet familja e shtetasit Q. A, e cila jeton prej mëse një viti në një çadër provizore të dhënë nga shtabi i emergjencës të qarkut Fier, në bazë të kërkesave të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, neni 18/b, kemi kërkuar shpjegime nga Prefekti i Qarkut Fier dhe Kryetari i Bashkisë Fier.

Në përgjigjen e dërguar nga Administratori i Njesisë Administrative Levan me shkresën nr.382/1, datë 09.12.2015, theksohet se, subjekti Q.A ndodhet në listën e familjeve të dëmtuara nga përmbytjet në muajin Shkurt 2015, gjë e cila vërtetohet dhe përmes dokumentacionit shoqëruar si, kopje e

proces verbalit të komisionit të konstatimit me nr.77, datë 03.02.2015 të ish-Komunës Levan, si dhe kopje e proces verbalit të komisionit vlerësimit të dëmeve me nr.77, datë 16.03.2015 të Këshillit të Qarkut Fier, ngritur në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit të Republikës të Shqipërisë “Për vlerësimin e dëmeve në banesa dhe pajisje, orendi shtëpiake të shkaktuara nga përmbytjet e muajit Shkurt 2015”, ku janë të detajuara dëmet e konstatuara dhe preventivi përkatës me vlerën financiare në shumën 2 231 280 (dy milion e dyqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier gjithashtu me shkresë nr.1431/1, datë 04.12.2015, thekson se, subjekti Q.A është i përfshirë në listën e subjekteve të dëmtuara nga përmbytjet e muajit Shkurt 2015. Në informacionin e dërguar konfirmohet nga ky Institucion se, procedura e ndjekur për vlerësimin e dëmit dhe përcaktimin e vlerës financiare për mbulimin e dëmit të shkaktuar, janë kryer në bazë të ligjit nr.8756, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, të ndryshuar dhe VKM nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Në vijim të procedurave ligjore, Këshilli i Qarkut Fier referuar VKM nr.329, datë 16.05.2012, pika 2/b ku thuhet se: “Këshilli i qarkut, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, përgatit listat përmbledhëse për subjektet private të pronave të dëmtuara, si dhe plotëson dokumentacionin me certifikatën familjare, fotokopjen e dokumentit të identifikimit dhe i paraqet ato në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC), në Ministrinë e Brendshme”, ka dorëzuar dokumentacionin përkatës sipas listës të familjeve të dëmtuara, mes të cilave dhe për subjektin Qemal Aliaj, pranë DPEC në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Në VKM Nr.965, datë 2.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave”, pika 8, parashikohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, në Ministrinë e Punëve të Brendshme është autoriteti kryesor për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile”, organ i cili në kuadër të bashkëpunimit me organet e qeverisjes vendore, pasi grumbullon informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm ligjor për subjektet e prekura nga fatkeqësia natyrore, nëpërmjet Ministrit të Punëve të Brendshme, propozon Këshillit të Ministrave miratimin e një VKM për ndihmën shtetërore që ju jepen familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore për mbulimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parashikon fondin që ju vihet në dispozicion subjekteve sipas listës të verifikuar nga organet përgjegjëse, i cili përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, si burimi parësor i financimit për përballimin e emergjencave civile, apo dhe burime të tjera.

Këshilli i Ministrave është organi përgjegjës për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në Republikën e Shqipërisë, i cili në zbatim të ligjit nr.8675, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, të ndryshuar, neni 5/dh, ku thuhet shprehimisht se: “...Vlerëson nivelin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera, në bashkëpunim me specialistët e organeve përgjegjëse, si dhe asistencën për riaftësim...”, miraton fondin përkatës për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë

natyrore, por planifikon gjithashtu fonde edhe për parandalimin e emergjencave civile, si dhe masat për rikthimin në gjëndjen e mëparshme në rajonin e prekur nga fatëkeqësia natyrore.

Nga informacionet e deritanishme të dërguara nga autoritetet publike në nivel vendor të Qarkut Fier pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, rezulton se, ky akt nënligjor nuk është miratuar akoma, duke sjellë për pasojë që shtetasit Q.A dhe familjes së tij, prej mëse një viti, shkelet e drejta e parashikuar në ligjin dhe aktet nënligjore të përmendura më lartë, për të fituar ndihmën shtetërore për mbulimin e dëmit të shkaktuar, për shkatërrimin e shtëpisë nga përmbytjet e ndodhura në muajin Shkurt 2015. Situata e kësaj familje e përbërë nga 5(pesë) persona, përkeqësohet akoma më shumë për shkak të kushteve të vështira ekonomike që po kalon duke jetuar në një çadër provizore, ndaj është shumë emergjente marrja e masave për sistemimin dhe strehimin e saj.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit.... paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË :

“Marrjen e masave nga organet tuaja, që në bashkëpunim, të përgatitni materialet dhe të dërgoni sa më parë nëpërmjet Ministrit të Punëve të Brëndshme, propozimin në Këshillin e Ministrave për miratimin e fondit për dhënien e ndihmës shtetërore shtetasit Q. A, për mbulimin e dëmit të shkaktuar në shkatërrimin e shtëpisë, nga përmbytjet e ndodhura në muajin Shkurt 2015, sipas vendimit të komisioneve përgjegjëse të ngritura për vlerësimin e dëmeve”.

Për masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të ktheni përgjigje brënda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Etilda GJONAJ(SALIU)